



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilbjenoi/Prodato Received/Delivery	23 - 11	2023	3 viti god year
Organ /Njësia Org./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKNDHCK	7084	2023	117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1178/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1178/2023, të datës 19.09.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë

, kundër Vendimit me numër nr.11/763 të datës 24.08.2023 të Kryesueses së Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Administratën Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1178/2023 e datës 19.09.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër nr.11/763 i datës 24.08.2023 i Kryesueses së Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Administratën Tatimore të Kosovës.
- III. Anullohet Konkursi me Nr. Reference: RN00011829 Lëvizje Brenda Kategorisë për dhjetë (10) pozita për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe të gjitha veprimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- IV. Obligohet Drejtori Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Administratës Tatimore të Kosovës, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të

zbatimit të këtij vendimi si në pikën III të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Administrata Tatimore e Kosovës, më datë 12.06.2023 ka shpallur Konkursin me Nr. Reference: RN00011829 Lëvizje Brenda Kategorisë për dhjetë (10) pozita për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës, ku afati për aplikim ka qenë nga data 27.06.2023 deri me datë 06.07.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 14.08.2023 ka qenë e renditur e 19 me gjithsejtë 50.6 pikë. E pakënaqur kundër njoftimit të datës 14.08.2023 ka parashtruar ankesë me datë 21.08.2023 tek Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë, ku përmes Vendimit me numër nr.11/763 të datës 24.08.2023 të Kryesueses së Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Administratën Tatimore të Kosovës i është refuzuar si e pabazuar ankesa e datës 21.08.2023 të pranuar përmes SIMBNJ për shkak se në bazë të vlerësimit gjatë intervistës me gojë nuk ka dhënë përgjigjet kuptimplota dhe të sakta para komisionit që të mund të shpallet kandidat i suksesshëm për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor"/edukimi (10) pozita me RN00011829.

Ankuesja kundër Vendimit me numër nr.11/763 të datës 24.08.2023 të Kryesueses së Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 19.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6147/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe kundër vlerësimit të kandidatëve në konkursin e shpallur të datës 12.06.2023 titulli i pozitës "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.10.2023 Këshilli ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 10.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me datë 02.11.2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 6147/2023 të datës 19.09.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga _____ për ankesa.kpmschck@rks-gov.net 19.09.2023; E-mail nga _____ për _____ i datës 16.08.2023; E-mail

nga . për . etj. i datës 25.07.2023; Njoftim i ATK me numër protokoll 11-711 i datës 21.07.2023; Renditja përfundimtare nga SIMBNJ i datës 14.08.2023; Vendim i ATK me numër protokoll 11-763 i datës 24.08.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 i . i datës 11.07.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 i . i datës 26.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022 i . i datës 13.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2022 i . i datës 25.01.2023; Konkurs Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK i datës 12.06.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.10.2023; Përgjigje në ankesë e datës 10.10.2023; Pikët e vlerësuar nga anëtarët e komisionit për kandidatët për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidaten . 1/5 faqe; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidatin . 1/5 faqe; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidaten . 1/5 faqe; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidatin . 1/5 faqe; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidaten . 1/5 faqe; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidatin . 1/5 faqe; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidaten . 1/5 faqe; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidaten . 1/5 faqe; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK; E-mail nga . për etj. i datës 21.08.2023; E-mail nga për . i datës 16.08.2023; Njoftim i ATK me numër protokoll 11-695 i datës 13.07.2023; Lista e aplikantëve nga SIMBNJ; Aprovim për publikimin e procedurës së rekrutimit Lëvizje brenda kategorisë i ATK me numër protokoll 11-501 i datës 18.05.2023; E-mail nga për . etj. i datës 25.07.2023; Njoftim mbi mbajtjen e intervistës me gojë në ATK i datës 27.07.2023; Njoftim mbi mbajtjen e intervistës me gojë në ATK i datës 28.07.2023; Vendim për themelimin e komisionit të vlerësimit brenda kategorisë i datës 07.07.2023; Njoftim mbi mbajtjen e intervistës me gojë në ATK me numër protokoll 11-726 i datës 25.07.2023; Njoftim mbi mbajtjen e intervistës me gojë në ATK me numër protokoll 11-726 i datës 25.07.2023; Ankesë kundër fazës së vlerësimit i . i datës 21.08.2023; Diplomë nga Kolegji UBT i datës 04.10.2017; Pasqyra e llogarisë së trustit e . i datës 01.08.2002-06.07.2023; Letërnjoftim i . Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2022 i . i datës 19.12.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2021 i . i datës 18.01.2022; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës për . i datës 01.08.2000; Certifikatë nga Usaid për A.U.D. i datës 27.04.2022; Vërtetim dëshmi mbi përvojën e punës në ATK i A.U.D. i datës 20.06.2023; Letërnjoftim i . ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2022 i A.U.D. i datës 27.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2021 i A.U.D. i datës 03.02.2022; Diplomë nga Kolegji Arbëri për . me numër nr.05/2022 i datës 28.10.2022; Diplomë nga SHME Marin Barleti për . me numër protokoll 1379 i datës 07.10.1999; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2022 i . i datës 27.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2021 i . i datës 24.01.2022; Vërtetim dëshmi mbi vërejtje disiplinore i . i datës 21.06.2023; Vërtetim dëshmi mbi përvojën e punës në ATK i . i datës 21.06.2023; Diplomë nga Kolegji Universum i . me numër nr.1912/21 i datës 24.03.2021; Certifikatë nga Usaid për . i datës 27.04.2023; Certifikatë nga abacomm i . e

muajit Qershor 2022; Certifikatë nga Co-head CFA për [] i datës 16.09.2000; Certifikatë nga zas trade për [] i datës 06.05.2000; Certifikatë nga zas trade për [] i datës 22.10.1999; Diplomë nga Unioni botëror ORT për [] i datës 28.06.2000; Certifikatë nga albacomm për e muajit Qershor 2002; Referencë nga ATK për [] i datës 09.06.2010; Letërnjoftim i Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i [] i datës 15.12.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 i [] i datës 31.12.2022; Vërtetim dëshmi mbi vërejtje disiplinore i [] i datës 03.07.2023; Vërtetim dëshmi mbi përvojën e punës në ATK i [] i datës 03.07.2023; Diplomë e [] e datës 26.05.2014; Certifikatë e notave nga Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren për [] e datës 23.06.2023; participimi i studenteve faturë e [] me numër 1077143; Certifikatë nga afas për [] i datës 18.01.2010; Certifikatë nga unwe për [] i datës 31.07.2022; Referencë nga asseco për [] i datës 19.04.2010; Referencë nga kpa për []; Letërnjoftim i []; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2022 i [] i datës 13.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 i []; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2021 i [] i datës 26.01.202; Vërtetim dëshmi mbi vërejtjen disiplinore i [] i datës 22.06.2023; Diplomë nga Kolegji AAB për me numër nr. 1739/18 i datës 09.10.2018; Vërtetim dëshmi mbi përvojën e punës në ATK i [] i datës 14.06.2023; Certifikatë nga albacomm për [] e muajit Qershor 2002; Letërnjoftim i []; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2022 i [] i datës 24.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2021 i [] i datës 27.01.2022; Vërtetim dëshmi mbi vërejtje disiplinore e [] i datës 14.06.2023; Certifikatë nga usaid për e muajit Prill 2018; Certifikatë nga kfos për [] i datës 20.12.2015; Diplomë nga Kolegji Fama për H.H. me numër nr.452/0817 i datës 01.08.2017; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 20.04.2023; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 27.02.2023; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 17.03.2022; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 28.09.2022; Certifikatë e avancuar profesionale për prokurim nga KRPP për [] me numër 563 e vitit 2022; Certifikatë nga MFPT për [] i datës 09.07.2021; Certifikatë nga MF për [] i datës 05.03.2019; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 14.02.2018; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 24.05.2016; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 07.03.2012; Certifikatë nga EDC për [] i datës 06.10.2018; Certifikatë nga QTZH për [] i datës 15.03.2017; Certifikatë për Microsoft office specialist për [] i datës 24.02.2017; Certifikatë nga BM training për [] i datës 20.07.2014; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 05.02.2016; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 21.02.2014; Certifikatë nga ECDL për [] i datës 15.04.2014; Certifikatë nga ECDL për [] i datës 21.10.2013; Vërtetim dëshmi mbi përvojën e punës në ATK i [] i datës 05.10.2022; Referencë për [] Letërnjoftim i [] Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022 i [] i datës 25.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i [] i datës 21.01.2022; Vërtetim dëshmi mbi vërejtje disiplinore i [] i datës 07.06.2023; Vërtetim dëshmi mbi vërejtje disiplinore i [] i datës 30.05.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e [] i datës 05.07.2023; Përgjigje në ankesë i datës 12.10.2023; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidaten [] 1/5 faqe; Certifikatë nga IKAP për [] i datës 22.02.2012; Certifikatë nga usaid për [] Akt Emërim i [] i datës 12.08.2011; Përshkrimi i detyrave të punës; Vendim me numër protokolli 11-282 i datës 03.09.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 i [] i datës 18.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën 01.01.2020-31.12.2020 i [] i datës 15.12.2020; Pyetjet e

intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidatin [redacted] 1/5 faqe; Diplomë e [redacted] me numër nr.118/12 i datës 22.12.2012; Akt Emërim i [redacted] me numër AE.Nr.625/2022 i datës 27.12.2022; Vendim për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit me numër nr.625/2022 i datës 27.12.2022; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; Letërnjoftim i [redacted] Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë Janar Dhjetor 2022 i [redacted] i datës 12.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë Janar Dhjetor 2021 i [redacted] i datës 20.01.2022; Vërtetim dëshmi mbi përvojën e punës në ATK i [redacted] i datës 27.06.2023; Vërtetim dëshmi mbi vërejtje disiplinore i [redacted] i datës 27.06.2023; Pyetjet e intervistës me gojë për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" në ATK pikët e fituara për kandidatin [redacted] 1/5 faqe; Diplomë nga Kolegji Iliria për [redacted] me numër nr.216/12 i datës 15.11.2012; Akt Emërim i [redacted] me numër AE.Nr.562/2022 i datës 05.01.2023; Vendim për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit me numër nr.562/2022 i datës 23.12.2022; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; Letërnjoftim i [redacted]; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2022 i [redacted] i datës 30.12.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë 2021 i [redacted] i datës 25.01.2022; Vërtetim dëshmi mbi vërejtje disiplinore i [redacted] i datës 05.07.2023; Vërtetim dëshmi mbi përvojën e punës në ATK i A.K. i datës 05.07.2023; Email nga [redacted] për [redacted] i datës 03.11.2023; E-mail nga [redacted] për [redacted] i datës 03.11.2023; Njoftim për kandidatët e suksesshëm nga Divizioni i Burimeve Njerëzore në ATK;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vendosjes në mënyrë meritore, duke marr parasysh interesin e nëpunësve civil të Administratës Tatimore të Kosovës, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, sipas nenit 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative", do të bëjë shqyrtimin e shpalljes së konkursit me Nr. Reference: RN00011829 për Lëvizje Brenda Kategorisë për dhjetë (10) pozita për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Marr parasysh faktin që Administrata Tatimore e Kosovës bazuar në dispozitat e Rregulloren Nr.02/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës ka filluar procesin e ristrukturimit dhe për këtë Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin V.nr.02/KR/2022 të datës 07.10.2022, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa ky komision ka nxjerr dy raporte: Raportin me numër Reference KR/ATK 08/2022 me numër protokollit 1810 të datës 05.12.2022 për pozitat e Drejtorëve të Departamenteve dhe Udhëheqësve të Divizioneve dhe Raportin me numër Reference KR/ATK 09/2022 me numër protokollit 1850 të datës 07.12.2022 për pozitat e nivelit profesional.

Ndaj këtij procesi nëpunësit civil të pakënaqur kanë pashtuar një numër të madh të ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rrjedhimisht Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me qëllim të vendosjes në mënyrë sa më meritore për këtë çështje në mbledhjen e mbajtur me datë 16.02.2023 ka nxjerr Vendim VMK/2023 me numër protokolli 1851/2023 përmes të cilit është vendosur që të bëhet monitorim i jashtëzakonshëm në Administratën Tatimore të Kosovës dhe ndërlidhur me këtë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në fazën e përgatitjes së raportit të monitorimit të jashtëzakonshëm.

Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë që procesi i ristrukturimit është proces i ndishëm dhe është proces voluminoz për shkak që është pranuar një numër i madh i ankesave ndaj procesit të ristrukturimit, Administrata Tatimore e Kosovës, ende pa pasur vendim përfundimtar lidhur me këtë proces ka shpallur konkurset për pozitën e kategorisë së nivelit të mesëm drejtues, kategorisë së nivelit të ulët drejtues dhe kategorisë së nivelit profesional, respektivisht më datë 12.06.2023 është shpall konkursi me Nr. Reference: RN00011829 për Lëvizje Brenda Kategorisë për dhjetë (10) pozita për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor", ndërsa sipas njoftimit për kandidatët e suksesshëm nga Divizioni i Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës janë zgjedhur shtatë 7 kandidatë.

Lidhur me këto konkurse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar kërkesë nga Sindikata e Administratës Tatimore të Kosovës e cila ka kërkuar që të bëhet pezullimi i këtyre procedurave deri në përfundimin e procedurës së shqyrtimit të ankesave që kanë të bëjnë me procesin e ristrukturimit brenda Administratës Tatimore të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.06.2023 përmes emailit dërguar Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës ku në njoftim ka qenë edhe Drejtori Ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës, ka kërkuar që meqenëse jemi në fazën e shqyrtimit të të gjitha procedurave të ristrukturimit të pezullohen të gjitha veprimet juridike në kuptim të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në raport me konkurset e shpallura, mirëpo nuk kemi marr ndonjë përgjigje. Përkundër kësaj, Administrata Tatimore e Kosovës ka vazhduar me shpalljen e konkurseve në këtë rast edhe me konkursin me Nr. Reference: RN00011829 për Lëvizje Brenda Kategorisë për dhjetë (10) pozita për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor".

Marr parasysh konstatimet si më lartë, Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave ligjore në fuqi, respektivisht Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili me nenin 130 paragrafi 1 dhe 2, ka përcaktuar se: "1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën. 2. Nëse në aktin administrativ përfshihen dy ose më shumë palë me interesa të njëjta, ankesa e paraqitur nga njëra nga palët, pezullon prodhimin e pasojave juridike të aktit ndaj të gjitha palëve të përfshira".

Andaj Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë kompetencën e përcaktuar me nenin 130 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke marr parasysh konstatimin si më lartë, dhe procedurën ligjore, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se deri në përfundimin e procesit të ristrukturimit si rezultat i nxjerrjes së raportit të monitorimit të jashtëzakonshëm dhe shqyrtimit të ankesave të ankuesve, nuk mund të merren asnjë veprim juridik për



shpalljen e konkurseve për pozitat përkatëse, kështu që në kuptim të zbatimit të këtij vendimi si në dispozitiv Drejtori Ekzekutiv dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore i Administratës Tatimore të Kosovës, janë të obliguar të ndërmarrin të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi.

Pas konstatimit për shkeljet e tilla me rastin e shpalljes së konkursit me Nr. Reference: RN00011829 për Lëvizje Brenda Kategorisë për dhjetë (10) pozita për pozitën "Inspektor i Mesëm Tatimor" të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës, atëherë Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në pretendimet ankimore të ankueses dhe në procesin e shqyrtimit të hapave procedural në këtë procedurë.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1178/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.